

Fjalë të Mëdha – Pjesa 3

Plot Pasion

Përshëndetje miq! Jemi në pjesën e tretë të serisë "Fjalë të Mëdha".

Sot do të shikojmë fjalët: **Plot Pasion**.

Mendoj që, pavarësisht situatave ku ndodhemi, një gjë nuk duhet të ndryshojë kurrë: ta duam Zotin plot pasion.

Është një varg i bukur te

Predikuesi 9:10 *'Tërë ato që dora jote gjen për të bërë, bëji me gjithë forcën tënde...'* bëji gjërat me pasion, plot pasion.

Jo thjesht si një punë për t'u bërë, me mediokritet, "hajde mo". Jo, jo, bëje me gjithë forcën tënde. "Me gjithë forcën tënde," është e kundërta e asaj që dëgjon shpesh:

-Si je?

-Po ja, e shtyjmë.

-Si po ja kalon në punë, në familje, në martesë, me fëmijët, në shkollë, në besimin te Jezusi?

-Hajde, e shtyjmë si gjithë të tjerët.

Nuk e gjen këtë shprehje në Bibël. Bibla thotë se kur ti bën një punë, kur dora jote prek një punë, ti duhet ta bësh me gjithë forcën tënde, të shkrish talentin tënd.

Kur ti zgjedh të besosh në Perëndinë, Ai trazon brenda teje pasionin dhe ti bëhesh pasionant për gjërat, jo thjesht për t'i shtyrë. Si thotë Perëndia, atë që dora jote gjen për të bërë, bëje me gjithë forcën tënde.

Po mirë, si mund të bëhet kjo gjë në mënyrë praktike? Shumë thjeshtë: sekreti është në këto katër fjalë:

Bëj Pak Më Shumë.

Mos bëj vetëm aq sa pritet; bëj pak më shumë.

Mos bëj vetëm atë që duhet bërë; bëj pak më shumë.

Nëse po mendon nëse ka një histori në Bibël për dikë që bëri pak më shumë dhe ia pa të mirën kësaj pune, po, në fakt ka një. Le të shohim një histori që shumë mund ta dinë, por ndoshta nuk e keni parë nga ky këndvështrim.

Te **Zanafilla 24** është një vajzë që quhet Rebeka. Abrahami donte një nuse për djalin e tij, Isakun, dhe filloi kërkimin për të.

Në ato kohë, (Abrahami jetoi rreth 2000 vjet para Krishtit), në atë periudhë, ishte zakon që familja të kërkonte nuse për djalin.

Mos më thuaj se edhe ti po pret që mami të të gjejë nusen, jemi në shekullin XXI pas Krishtit; ky diskutim për të gjetur nusen nga prindërit ishte një zakon i zakonshëm 20 shekuj para Krishtit. (shaka)

Prit, është shumë e bukur kjo histori.

Abrahami cakton mikun e tij më të besuar, Eleazar, për këtë punë. Ai i thotë: “Dua të shkosh në një qytet të caktuar për të gjetur nusen e duhur për djalin tim, Isakun.” Dhe e di sa larg ishte vendi që i tha Abrahami? Ishte gati 1.000 km, si nga Tirana deri në Trieste ose Venecia.

Eleazi ishte i tensionuar për këtë mision të vështirë, duke pyetur nëse do të ishte e duhura, nëse do të ishte saktësisht ajo që dëshiron Perëndia. Dhe çfarë bën ai? I lutet Perëndisë. Ja sesi lutet:

Zanafilla 24:12 *"O Zot, Perëndia i zotërisë tim Abraham, të lutem bëj që sot të kem mundësinë të kem një takim të lumtur, trego dashamirësi ndaj Abrahamit, zotit tim!"*

Sa i përkushtuar dhe i kujdesshëm ishte Eleazi! Çuna/goca, lutuni për personin e jetës suaj. Mos e shihni vetëm nga pamja fizike ose parametrat e tjera.

Zanafilla 24:13 *'Ja, unë po rri pranë këtij burimi ujërash, ndërsa bijat e banorëve të qytetit dalin për të mbushur ujë.'*

Dhe Ai thotë më poshtë: “Perëndi, unë do ta dalloj nëse ajo është nusja e duhur nëse ajo bën dy gjëra.”

Shërbëtori i Abrahamit lutej e lutej, duke i kërkuar Perëndisë këto dy gjëra. Në mbrëmje, të gjitha vajzat dhe gratë e fshatit vinin dhe mbushnin ujë nga një pus i vetëm.

Ilustrim: A ka ndonjë këtu që është 45 vjeç e më lart? Sepse unë e mbaj mend kur isha fëmijë, në fshatin tonë, kishim një çezmë për gjithë lagjen dhe gjithë lagjja shkonte për të mbushur ujë në mëngjes dhe në mbrëmje. Dhe djemtë e lagjes, ku ishin gjatë asaj kohe? Rrotull, nuk vinin për të mbushur ujë. Pse vinin dhe nuk kishin kova ose gjyma uji? Si do e merrnin ujin këta? Kështu mendoja atëherë, pasi isha i vogël dhe nuk e kuptoja që ata vinin për të takuar vajzat, jo për ujë.

Tani, kthehemi te historia jonë. Vargu 14 tregon dy gjërat për të cilat u lut shërbëtori i Abrahamit.

Zanafilla 24:14 *'Bëj që vajza së cilës do t'i them: "Ah, ule shtambën tënde që unë të pi" dhe që do të më përgjigjet: "Pi, dhe kam për t'u dhënë për të pirë edhe deveve të tu", të jetë ajo që ti ja ke caktuar shërbyesit tënd Isak. Nga kjo unë do të kuptoj që ti ke treguar dashamirësi ndaj zotërisë tim".'*

Shenja ishte: vajza e duhur është ajo që tregohet dyfish e mirë me një person të huaj. Po ku bëhet fjalë për këtë vështirësi? Tek pjesa... edhe deveve të tua.

Si, çfarë thua? Ai po udhëtonte me 10 deve.

E kuptoj që t'i japësh ujë atij, sepse sapo të jetë i etur, do pijë 2 ose 3 gota, pra, një litër ujë ose më shumë nga pusi. Por 10 deve? Abrahami ishte shumë i pasur, ndoshta më i pasuri në botën e asaj kohe. Kishte nisur 10 deve me gjëra të mira që zotëronte për familjen e kësaj vajze. Nuk ishte një qese, një çantë dore, një çantë shpine, ose disa kuti të bagazhit të makinës.

Ai kishte shkuar me 10 deve të ngarkuara plot, si një karavan të mbushur me pasuri.

Kthehemi te devetë. Nëse kërkon në Google sa ujë pi një deve, thotë deri në 200 litra; pra, për 10 deve? Më mirë mos e bëj shumë. Po mendo sa merr kova e pusit. Kova më e madhe e pusit që kam parë unë ka qenë diku 3-5 litra, sepse nuk ngrihet lehtë lart nëse është më shumë.

Shiko, i bie që ajo duhet të mbushë shumë kovë ujë nga pusi. Një kërkesë e tillë është e madhe. A thua kishte ndonjë vajzë në atë fshat që mund ta bënte këtë?

Pse nuk bëri një kërkesë më të thjeshtë, more Eleazar? P.sh., vajza e parë që do të vijë te pusi, ose e treta që do të vijë, ose e shtata. Ose vajza më elegante, ajo me sytë ngjyrëqielli, bjonde, ose ku e di unë.

Jo, nuk tha asgjë për këto. Lutja ishte: "Zot, vajza që do të bëjë minimalen (ujë për një të etur) dhe **pak më shumë**."

Si vazhdon historia?

Zanafilla 24:15-16 *'Ai s'kishte mbaruar së foluri, kur, ja, doli Rebeka me shtambën në shpatullën e saj; ajo ishte e bija e Bethuelit, biri i Mikailit, gruaja e Nahorit dhe vëllai i Abrahamit. Vajza ishte shumë e bukur, e virgjër dhe asnjë burrë nuk e kishte njohur kurrë. Ajo zbriti në burim, mbushi shtambën e saj dhe u ngjit përsëri lart.'*

Ishte e bukur, jo thjesht shumë e bukur dhe e virgjër, tamam, jo e virgjër me korrigjime rrugës. Rebeka, ç'të them, ishte miss fshati. Si e thoni në dialektin tuaj për një vajzë që është shumë e bukur? Bukuroshe, bukurane, sy shkruar, si rrush...

Dhe kur Eliazari i kërkoi ujë, ajo ishte bukuroshja e fshatit. Si tha? *"Ik, a e di ti me kë po flet? Nuk e kam marrë kurorën me vete, por unë jam miss fshati. Do vras duart duke të mbushur ujë ty, do më bëhen duar me kallo? Jo, jo, ti do vish të më shërbesh mua dhe njëherë shpejt. Unë vij të mbush ujë se më ka urdhëruar vëllai i madh; për atë nuk kam çfarë ti bëj. Po ti, ik ore, zhduku!"*

A nuk duket se një vajzë e tillë do t'i përgjigjej kështu?

Rebeka, në fakt, me gjithë mirësinë dhe pasionin e saj, i tha Eliazarit: "Po, do të të jap ujë që të pish ti." Por pastaj, ajo shtoi, "Por do të bëj pak më shumë."

Zanafilla 24:17-19 *'Atëherë shërbyesi vrapoi në drejtim të saj dhe i tha: "Lërmë të pi pak ujë nga shtamba jote". Ajo u përgjigj: "Pi, zotëria im"; pastaj shpejtoi ta ulë shtambën mbi dorë dhe i dha të pijë. Sapo mbaroi së dhëni ujë për të pirë, tha: "Do të mbush ujë edhe për devetë e tua, derisa të ngopen me ujë".'*

Kur lexon këtë varg, habitesh. Ajo nuk ishte thjesht një vajzë e bukur; ajo kishte një karakter të bukur. A nuk duket si vargu i parë që lexuam?

Predikuesi 9:10 *'Tërë ato që dora jote gjen për të bërë, bëji me gjithë forcën tënde...'*

Sepse të ngopësh 10 deve me ujë nuk është punë e lehtë.

Ilustrim: Kur ishim fëmijë në fshat, lopët nuk i nxirrnim jashtë në dimër. Dhe mami, sepse shkonte në punë, na kërkonte që t'i jepnim ujë lopës, por duhet të ngrohnim një kusi dhe pastaj ta përziejmë me ujë të ftohtë, sepse ajo nuk e pinte ujin të ftohtë fare. Dhe, duhej punë të ngopje lopën me ujë, ne kishim vetëm një kusi. Ne ziheshim kur duhej ta ngopte lopën me ujë.

Por kjo motra te Zanafilla, pa i thënë askush asgjë, i dha ujë 10 deveve. Ulte e ngrinte kovën, dhe krahët e saj ishin të fuqishëm, me muskuj si gurë. Kishte gjasa që ngjante si një personazh nga filmi *Wonder Woman*, për ata që e njohin filmin, me një luftëtare të fuqishme që mund të thyente gjithçka. Imagjinoni Rebekën, e palodhur, që i dha ujë Eliezerit dhe 10 deveve të tij. Devetë janë si shporta, hidh ujë dhe nuk ngopen.

Por ajo nuk e dinte se duke bërë pak më shumë, thjesht po ndihmonte dikë pak më shumë se sa i ishte kërkuar, dhe nuk e dinte se po e priste një bekim shumë

të madh. Nga ajo që bëri, do të ndryshonte drejtimi i jetës së saj. Ajo thjesht iu dha mundësia, dhe atë që iu kërkua e bëri me gjithë forcën e saj. Për të ishte një ditë e zakonshme dhe iu dha një mundësi e vogël. Por, atë gjë që iu dha, e bëri me shumë pasion, sikur po e bënte për Zotin.

Ajo nuk e dinte se duke bërë këtë gjë, do të kishte burrin e jetës nga ana tjetër. Dhe Perëndia jo vetëm që do të lejonte që ajo të martohej në familjen më të pasur të asaj kohe, por ajo do të ishte pjesë e linjës së familjes nga do të vinte vetë Jezusi.

E vetmja arsye pse u zgjodh Rebeka ishte se ajo zgjodhi të bënte pak më shumë. Rebeka jo vetëm që u bind, por bëri pak më shumë. Nuk bëri vetëm punën që iu kërkua, bëri pak më shumë. Dhe ajo do të jetë stër-stër-stërgjyshja nga do të vinte Maria, nëna e Jezusit. Wow, a i vlejti që bëri pak më shumë?

Po ti? Po ne, nëse do të kishim këtë qëndrim, do të bënim atë që na thotë Perëndia, por do të bënim pak më shumë se sa na kërkohet?

Po sikur në punën tënde të kishe këtë qëndrim, të bëje atë që kërkohet dhe më pas të bënit pak më shumë? Apo ndoshta thua, "Unë këtë që po më kërkojnë mezi po e bëj. Nëse do të bëjnë të tjerët, e bëjnë, por unë, sapo të përfundoj këtë, do të iki dhe do të fshihem nëse më kërkohet më shumë."

Si tha Jezusi: "Nëse dikush të kërkon të ecësh një milje, ec edhe një milje më shumë." Kur Jezusi dha këtë këshillë, ai i referohej ligjeve romake.

Kur ushtarët romakë ishin të ngarkuar dhe kishin nevojë për ndihmë për të mbajtur një çantë, ata mund të kërkonin që dikush ta mbante atë për ta deri në një vend të caktuar. Jezusi tha, nëse të kërkojnë të mbash diçka për një milje, bëj pak më shumë se sa kërkohet.

Jezusi po thotë, "Mos e bëj punën sa për sy e faqe. Bëje me gjithë forcën tënde dhe bëj pak më shumë." Dhe këtë këshillë, ai e dha për armikun. Nëse armiku të kërkon të bësh diçka, bëj pak më shumë.

Po për ata që ti do, për punën që siguron të ardhura për familjen tënde? Jezusi tha, "Kur bën një punë, bëje sikur po e bën për mua, bëje me aq pasion dhe cilësi sa do ta prezantoje atë punë për mua."

Sepse kur të vijë radha për promovim, kujt do t'i kërkojë shefi ose drejtori mundësinë? A do t'ia kërkojë atij që mezi bën atë që i kërkohet, apo atij që bën pak më shumë se sa kërkohet?

Ka shumë gjasa që do jesh ti ai personi, sepse ti po bën pak më shumë se sa kërkohet.

John Maxwell është një GURU i lidërsipit. Një ditë, nipi i tij e pyeti: "Gjysh, çfarë të bëj ndryshe në punën time të re?" Maxwell i tha: "Shko në punë më herët se sa të kërkohet, ik më vonë se sa të kërkohet, dhe gjatë kohës së pushimit bëje më shkurt se sa të lejohet. Bëj pak më shumë se sa kërkon shefi ose drejtori."

Dhe brenda një viti e gjysmë, ai u ngrit në detyrë, sepse shefi i tij po kërkonte dikë që të ishte mbikëqyrës i punës. Pse e zgjodhi atë? Sepse ai bënte pak më shumë.

Shiko, mentaliteti i zakonshëm është që si shqiptarë shpesh mendojmë: "Shko në punë, bëj sikur punon." Nëse ti bën si shumica, shkon në punë dhe bën sikur punon, edhe shefi do bëjë sikur do të të paguajë. Kjo do të thotë se rroga jote nuk do të rritet për një kohë shumë të gjatë. Ose do të mbetesh në një vend pune për një periudhë të gjatë, ose do të largohesh nga ajo punë.

Dua të të nxis ty që po dëgjon dhe je në punë: bëj pak më shumë. Ti që je në shkollë, përkushtohu pak më shumë. Është shumë e lehtë të gjesh justifikime.

Nëse do kërkosh justifikime, e di sa e lehtë është? Kur Eva dhe Adami kërkuan justifikime për mosbindjen e tyre ndaj Perëndisë, edhe ti do e kesh shumë të lehtë, sidomos në këtë kohë, të gjesh justifikime.

Por ti ji ndryshe, ji si Rebeka—bëj **pak më shumë**.

Unë dua të jem vetë një pastor i tillë për kishën, të bëj pak më shumë për anëtarët e kishës dhe për kishat e tjera që ndihmojmë. Dua që çdo person që është këtu, të jetë ky lloj personi.

Unë bëj pak më shumë sesa më kërkohet.

Imagjino si do të ishte martesë jote nëse ti do bëje pak më shumë për partnerin tënd. Thotë burri, "A ma bën një kafe?" Ti i bën kafe dhe i mbush dhe një gotë ujë. Ose i jep një birrë dhe i çon dhe një qese patatina.

Ose ndihmon gruan me diçka dhe bën më shumë sesa të kërkoi. Thuaji gruas fjalë dashurie, sa e mirë është, sa e zonja, —gjithë komplimentet e mundshme. POR bëj pak më shumë sesa fjalët e bukura.

Si do të ishte martesë jote nëse të dy do të bënit pak më shumë? Jo thjesht ca lule të bukura për Shën Valentin dhe një dhuratë për ditëlindje, por bëj surpriza të vogla herë pas here. Si do të ishte martesë juaj?

E di si do të ishte? Do të të duhej të merrje urgjencën në telefon sepse asaj do t'i pushojë zemra nga gjithë gjërat e mira që po bën për të. Hiqja trurin burrit, pushoja zemrën gruas me surpriza të bukura.

Dua të sfidoj shumë: bëhu ky lloj personi këtë javë, bëj pak më shumë.

Po sikur ne si kishë, ne si ndjekës të Jezusit, të ishim të tillë, të gjithë të tillë, të bënim pak më shumë për dikë?

Ose mund të jemi egoistë, të presim se çfarë po bëjnë të tjerët për ne, dhe nëse nuk bëjnë, të fillojmë të kritikojmë, të themi " Çfarë kishe koti, çfarë pastori koti, çfarë drejtuesi koti ka kjo kishë".

Ose të jesh ti që bën ndryshimin, të bësh pak më shumë sesa kërkohet. Nëse këto kohë nuk po bën asgjë, bëj diçka, bëj minimalen për dikë.

Ka fuqi kur dy ose më shumë adhurojnë së bashku. Nga e di unë?

Pali dhe Sila ishin në burg në Filipinë dhe, në vend që të qanin dhe të ankoheshin për situatën e tyre të vështirë, ata e kthyen qelinë në një vend adhurimi. Në mes të natës, ata filluan të këndonin dhe të lavdëronin Zotin me këngë dhe lutje. Ja se çfarë ndodhi:

Veprat e Apostujve 16:25 *'Aty nga mesnata Pali dhe Sila po luteshin dhe i këndonin himne Perëndisë; dhe të burgosurit i dëgjonin.'*

Veprat e Apostujve 16:26 *'Befas u bë një tërmet i madh, sa që u tundën themelet e burgut; dhe në atë çast u hapën të gjitha dyert dhe të gjithëve iu zgjidhën prangat.'*

Wow, tërmet! Prania e Perëndisë është aq e fuqishme, kur ti lavdëron Perëndinë pavarësisht kushteve, sa që prangat e mëkatit dhe çdo lloj pengese do të bien vetë nga duart e njerëzve. Sepse ka fuqi kur dy ose më shumë adhurojnë Zotin së bashku.

Kur të krishterët nuk kanë turp të adhurojnë Perëndinë aty ku janë, duke kaluar përtej paragjyqimeve dhe frikës për atë që mendojnë të tjerët, dhe adhurojnë Perëndinë, çdo lloj prange do të bjerë në tokë.

Kur ju si prindër adhuroni Perëndinë, fëmijët do të adhurojnë me ju. Kur ju si fëmijë adhuroni Perëndinë, prindërit tuaj do të bashkohen me ju. Kur ti si vëlla ose motër adhuron Perëndinë, vëllezërit dhe motrat e tua do të bashkohen me ty.

Le ta adhurojmë Perëndinë, pak më shumë se normalisht në këto rrethana që jemi.

Kush e mban mend Jobin? Ai ishte i tillë; ai e adhuronte Perëndinë pak më shumë se normalisht, edhe kur rrethanat e tij ishin të vështira. Edhe kur gruaja i tha: "Mallko Perëndinë dhe vdis!"

Në fakt, nuk është pjesë e historisë pse i tha gruaja Jobit, mallko Perëndinë dhe vdis. Por Jobi kishte dy mundësi:

1. **Të mallkonte Perëndinë dhe të vdiste.**
2. **Të bekonte Perëndinë dhe të jetonte.**

I humba fëmijët, humba pasurinë, humba shëndetin, kam humbur çdo gjë. **Por unë do të lavdëroj Perëndinë gjithsesi.**

Dhe historia e jetës së tij merr një drejtim tjetër.

Edhe ti ke dy zgjedhje: mund të ankoesh, “Nuk shkoj në kishë, sepse nuk kam kohë, nuk kam këtë, nuk kam atë. S’më kanë marrë as pastori, as gruaja e vet në telefon, nga inati nuk do ftoj njeri në kishë; nuk më del gjumi.” Vazhdo kërko, do të gjesh shumë justifikime, nëse kërkon.

Ose, ose, ose ti thua: **“Pavarësisht rrethanave, unë do të adhuroj Perëndinë.** Unë do të lutem për kishën time, unë do të lutem për drejtuesit e mi, edhe pse nuk ndihem sikur duhet ta bëj.”

Unë do të bëj pak më shumë se sa më kërkohet.

Perëndia ynë është i tillë. Ai bën pak më shumë për ne. Ai nuk kujdeset për ne vetëm sa për të mbijetuar, minimalen. Ai thjesht mund të na kishte falur mëkatet me vdekjen e Jezusit në kryq, dhe ne do të ishim shumë të lumtur me kaq.

POR, Ai është Perëndia që bën pak më shumë për ne. Jezusi nuk vdiq në kryq vetëm për të paguar për mëkatet tona; Ai bëri pak më shumë. U ringjall nga vdekja. Jo vetëm kaq, Ai bëri përsëri pak më shumë, duke sjellë Frymën e Shenjtë si dhuratë për çdo person që zgjedh t'i besojë Jezusit.

Do ta mbyll me historinë nga Numrat 16.

Në këtë kohë, shumë njerëz janë duke kërkuar Perëndinë. Por si mund ta dimë se cili është Zoti i vërtetë që duhet të ndjekim? Si mund të jemi të sigurt se cili drejtues shpirtëror është i duhur për ne? Si mund të jemi të bindur se Jezusi është drejtuesi i vërtetë shpirtëror?

Perëndia në Numrat 16 na jep një pamje të qartë për këtë. Perëndia urdhëroi që të gjithë fiset e Izraelit të sillnin nga një degë bajame. Ata e prenë çdo degë dhe e vunë në vendin e shenjtë. I lanë aty për 24 orë dhe do të ktheheshin në mëngjes. Kjo qëndronte për një provë: cilat degë do të lulëzonin dhe do të gjallëronin, ai do të ishte drejtuesi shpirtëror i Izraelit që Perëndia kishte zgjedhur nga ai fis.

Kur u kthyen, shkrimi thotë se vetëm dega e Aaroni-t kishte lulëzuar dhe ishte gjallëruar.

Kush e mban mend këtë histori nga Numrat 16?

Nëse ti je në kërkim dhe Perëndia të thotë të njëjtën gjë, si mund të ndash drejtuesit shpirtërorë? Nëse po kërkon kë të ndjekësh—Muhametin, Budën, Baba Aliun, apo Jezusin—Perëndia e bëri të njëjtën gjë me të gjithë: i preu dhe ata vdiqën. Por kush u kthye në jetë, kush gjallëroi përsëri? Ai është drejtuesi shpirtëror që duhet të ndjekësh. Jezusi është i vetmi që u ringjall. Ai e la veten të kryqëzohej, e varrosën dhe pas tre ditësh u ringjall.

Ai është rruga që Perëndia ka zgjedhur për të shkuar në qiell. Dhe Bibla thotë, kur ti zgjedh t'i besosh Atij, Ai do bëjë **Pak Më Shumë** për ty. Ai do të të falë mëkatet, por do të bëjë më shumë—do t'i japë qëllim jetës tënde, do të të japë Frymën e Shenjtë, dhe do të të japë sigurinë e Përjetësisë.

Nëse vendos të zgjedhësh sot Jezusin, nuk do ta harrosh kurrë këtë ditë. Ti do të njohësh Jezusin që të dha liri, që të hoqi prangat e mëkatit dhe të dha pak më shumë: një jetë të re, një jetë me qëllim, fuqinë e Frymës së Shenjtë. Ai të jep hir dhe favor çdo ditë.

Dua shumë të lutemi bashkë në këtë moment.

Jezusi tha, “Unë kam ardhur që të jap jetë dhe jetë me bollëk.” Ai mund të gjallërojë jetën tënde, martesën tënde, punën tënde, shkollën tënde. Ai mund të të çlirojë dhe të kthejë situatën në favorin tënd, nëse ti e dorëzon jetën tënde në duart e Tij. Ky është një moment shumë i veçantë në jetën tënde. Dy momente janë më të bukurat në jetë: dita kur linde dhe dita kur njohe Jezusin dhe zbulove qëllimin e jetës.

Le të lutemi!

Lutja e shpëtimit.